



PROVIM I MATURËS SHTETËRORE 2019

I DETYRUAR

Lënda: Gjuhë Shqipe dhe Letërsi

Model Testi

Udhëzime për nxënësin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim dhe arsyetim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa									
Pikët									
Kërkesa									
Pikët									
Kërkesa									
Pikët									

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1..... Anëtar/e

2..... Anëtar/e

PJESA II

LETËRSI

Poradeci

Kur në flakë

Kur në flakë të qiririt ze mendohem net-për-net
 Dh'e ndej shpirtin e kulluar nëpër dritën që më tret
 Prej skëterrës së pa matë më del bot' e ëndërruar,
 Vetëm ti, o im-e dashur net-për-net më ri larguar.

Po çdo ëndërr që më çfaqet prej skëterrës së pafund,
 Çdo mendim i llaftaruar që më dhemb e më përtund,
 Dyke rënë prej së lartash posi pikë zembërate
 T'i përshkohet për-së-felli bukuris' së qenies sate.

T'i përshkohet mes-për-mezi dlirtësis' së shpirtit tënd,
 Ta merr pamjen e fytyrës, bëhet shkronjëz e kuvënd.
 Ay del prej shkretëtire mënt' e mi të m'i stolisë
 E ka tingëll llaftarie, ka verbimin e magjisë,
 Ndrin i kthiellt e i pastër si pasqyrëz' e një kroj
 E nër të fytyrën t'ënde t'a vështroj...nuk t'a vështroj...

O! fytyr' e vjershëruar që më mbush me dëshërimë!
 Q'i fal gas përjetësie dashuris' së zemrës s'ime!
 Që më bën kur mënt' e mija regëtijnë varg e varg
 Të të ndej aq fare pranë, të më jesh aq shumë larg.

19. Gjendja shpirtërore e unit lirik në vargjet e mësipërme shpaloset përmes kontrastit: **1 pikë**

- A) dashuri/vuajtje;
- B) fitore/humbje;
- C) optimizëm/pesimizëm;
- D) trishtim/ngushëllim.

20. Në vargun: *Po çdo ëndërr që më çfaqet prej skëterrës së pafund*, simboli i **skëterrës** lidhet me: **1 pikë**

- A) errësirën e natës si proces natyror;
- B) errësirën e pushtimit të zemrës nga dashuria;
- C) ngjyrën e errët të kujtimeve të trishta;
- D) thelbin e natyrës njerëzore (pavetëdijen).

21. Sipas poetit rruga e bashkimit të shpirtave të kulluar e të dëlirë sigurohet përmes: **1 pikë**

- A) ëndrës (si gjendje që i paraprin realitetit);
- B) fjalës së poezisë (si model i procesit krijues);
- C) magjisë (si fenomen i mbinatyreshëm);
- D) perëndisë (si krijuese e universit).

22. Cilat janë shqisat që ngacmohen më së shumti në këtë poezi? 1 pikë

23. Si e perceptoni portretin e femrës, të sjellë nga Lasgushi në poezinë e mësipërme? 1 pikë

24.
a) Zbërtheni nëntekstin që mbart titulli i poezisë. 2 pikë

b) Kandili është marrë nga folklori si shprehje e *simbolikës së jetës*. Cili është kuptimi *original* që i jep Lasgushi këtij simboli në poezi? 1 pikë

25. Zbuloni detajin që autori e merr nga natyra, për të krijuar një imazh të caktuar në këtë poezi. Cila është figura stilistike e krijuar? Interpretoni imazhet që ju zgjohen nga ky përdorim. 3 pikë

Detaji: _____

Figura: _____

Interpretimi: _____

26. Identifikoni një veçori të formës së lirikës së Poradecit, duke ilustruar me vargje nga poezia. 2 pikë
